

2020

TRANSFERET NDËRKOMBËTARE TË PARAVE KONCEPTE BAZIKE

Banka Qendrore e
Republikës së Kosovës dhe
Grupi i Bankës Botërore
me mbështetjen e Qeverisë Zvicerane



Kjo broshurë është një produkt i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave (Payment Systems Development Group - PSDG) në Praktikën e Financës, Konkurrencshmërisë dhe Novacionit në Bankën Botërore.

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (State Secretariat of Economic Affairs - SECO) Zvicëran mundësoi financimin për këto materiale në kontekstin e programit të remitancave dhe pagesave.

www.remittanceprices.worldbank.org



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org
Telefon: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763



Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org
Telephone: +1 202 473-1000

Fotografia e kopertinës nga Spencer Montero

© Grupi i Bankës Botërore, 2020

TRANSFERET E PARAVE

Në rast se jeni shtetas rezident i cili merr / pranon para nga jashtë vendit, **është e rëndësishme të familjarizoheni me format e standardizuara të dërgimit dhe marrjes së parave** në Kosovë, me qëllim që transferet tuaja të jenë më të shpejta, më të sigurta dhe më pak të kushtueshme.



LLOGARITË BANKARE

Me hapjen e një llogarie bankare në valutë të huaj në njërën prej bankave komerciale, ***mund të dërgoni dhe të merrni shuma parash*** në këtë valutë.

Për hapjen e llogarisë, ju duhet dokumenti juaj identifikues dhe certifikata e shtetësisë, dhe të nënshkruani kontratën e ofruar nga banka ku kërkonti të hapni llogarinë.

“

Para se të hapni një llogari, informohuni me anë të fletëpalosjeve promociionale rreth tarifave mujore dhe komisioneve bankare që ofron banka. Merrni oferta nga disa banka të ndryshme.

LLOGARITË BANKARE

Pas hapjes së llogarisë, që të mund të merrni para nga jashtë, duhet të ndani të dhënat e transferit që ju jep banka, me dërguesin. Detajet e transferit përgjithësisht përmbajnë të dhënat në vijim:

- » **Emri dhe adresa e bankës;**
- » **Kodi ndërkombëtar i bankës (SWIFT ose BIC);**
- » **Emri juaj i plotë dhe adresa;**
- » **IBAN-i i llogarisë suaj.**


Këshillohet që të ndahen gjithashtu edhe informacionet në vijim:

- » **Emri i bankës së dërguesit (nëse e dispononi);**
- » **Valuta e llogarisë.**



SHOQËRIA PËR TELEKOMUNIKIM FINANCIAR NDËRBANKAR


SWIFT - Shoqëria për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Mbarëbotëror (*Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication*) është një **rrjet ndërkombëtar bankar**, i cili siguron shkëmbim me cilësi dhe siguri të lartë mesazhesh nëpërmjet bankave kudo në botë dhe pranohet në një numër të madh shtetesh.



SHOQËRIA PËR TELEKOMUNIKIM FINANCIAR NDËRBANKAR

Teknologjia SWIFT mundëson qasjen e shumë institucioneve financiare nëpërmjet proceseve të automatizuara, duke reduktuar kohën e transfereve.


Kodi SWIFT ose **BIC - Kodi Identifikues i Bankës**, i cili jepet së bashku me të dhënat e transferit, përfaqëson numrin e identifikimit unik të bankës suaj.



NUMRI NDËRKOMBËTAR I LLOGARISË BANKARE

IBAN - Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare është numri unik i identifikimit të llogarisë suaj bankare, i cili pranohet si standard në operacionet ndërkombëtare të pagesave. **IBAN në Kosovë përmban një total prej 20 shifrash apo shkronjash.**

Standardi i IBAN garanton një përpunim të flukseve hyrëse ndërkombëtare në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme, si dhe një risk të reduktuar gabimesh, të cilat mund të ndodhin si pasojë e ndryshimit të numrave apo gabimeve ortografike.



BANKA NDËRMJETËSE

Banka ndërmjetëse është një **bankë e huaj** e cila kryen shërbime financiare në një shtet tjetër, për llogari të bankës suaj në Kosovë.


Forma më e zakonshme e bashkëpunimit është administrimi i depozitave në valuta të caktuara sipas nevojave të bankës partnere.

Avantazhet e këtyre veprimeve janë shpejtësia në transfere dhe tarifa më të ulëta për transaksionet, për të dyja palët (në varësi të metodës së zgjedhur të pagesës).



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME BANKA NDËRMJETËSE?

Diagrami më poshtë ilustron më së miri se si përpunohen urdhërpagesat me dhe pa bankë ndërmjetëse:



Këshillë: Merrni informacion rreth bankave ndërmjetëse në shtetin e dërguesit së bashku me të dhënat e pagesës hyrëse. *Ndajeni këtë informacion me dërguesin e transferit, për të bërë zgjedhjen më të mirë për ju.*

Në rast se një urdhërpagesë kalon nga banka A tek banka B, kostoja totale e transferit është më e lartë.

Kujdes! Merrni parasysh gjithmonë numrin e bankave ndërmjetëse, pasi secila prej tyre ka tarifën e saj.

KOSTOT E TRANSAKSIONIT PËR TRANSFERET BANKARE

Kostot e remitançave = Shuma e dërguar – Shuma e pranuar

Dërgesa e parave shkakton kosto, ndaj është e rëndësishme të informohemi në lidhje me to. Kostoja totale e transferit përfshin tarifat e vendosura nga banka vendase, si dhe ato ndërmjetëse, kursi i këmbimit dhe kosto të tjera bankare (administrative) të vendosura nga bankat apo institucionet rregullatore.

Dërguesi vendos kujt i ngarkohet kostoja e transfertit, me nxjerrjen e urdhërpagesës. Mundësitë janë si vijon:

- » **OUR** – të gjitha tarifat i ngarkohen dërguesit
- » **SHA** – kostoja e transferit ndahet ndërmjet dërguesit dhe pranuesit, ose
- » **BEN** – të gjitha tarifat i ngarkohen pranuesit.



KOSTOT E TRANSAKSIONIT PËR TRANSFERET BANKARE

Për të kuptuar më mirë përdorimin e llogarisë bankare, është e rëndësishme të njohim dhe kuptojmë faktorët të cilët ndikojnë në koston totale. Këta faktorë janë:

- » Shuma totale e parave të transferuara;
- » Përdorimi i bankës ndërmjetëse;
- » Lidhjet e biznesit ndërmjet shteteve dërguese-pranuese;
- » Kërkesa për dërgesa të menjëhershme;
- » Kursi i këmbimit;
- » Tarifa e politika administrative të bankës dërguese.



OPERATORË TË TRANSFERIMIT TË PARAVE - MTO

MTO mundësojnë *kryerjen e transfereve të parave pa pasur nevojë për llogari bankare*. Transferet janë të shpejta dhe të thjeshta, dhe në Kosovë kryhen nëpërmjet bankave komerciale si përfaqësues të autorizuar.

Për të marrë shumën e dërguar, përveç paraqitjes së numrit të identifikimit personal, pranuesi i parave duhet të përcaktojë emrin e plotë të dërguesit, shtetin nga ku janë dërguar paratë, shumën e pritur dhe numrin e kontrollit të transferit të dhënë nga dërguesi.



OPERATORË TË TRANSFERIMIT TË PARAVE - MTO

Tarifat kryesisht varen nga shuma e transferuar, p.sh tarifë fikse për sasinë deri në 100 euro, ose 200 - 400 euro etj.

Është e rëndësishme që:

- » të mos humbasë numri i dhënë nga dërguesi për transferin bankar;
- » të merret informacion mbi mbrojtjen nga mashtrimet;
- » të kujtohet që disa shërbime kanë limit mujor transferi;
- » dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e konsumatorit gjatë transferimit të parave, nuk aplikohen në rast përdorimi të MTO-ve.

Këshillë: Dërguesit e parave duhet të kenë parasysh që tarifat varen nga shuma e parave të dërguara dhe nga shtetet nga/ku do të dërgohen paratë. Dërguesi duhet të informohet në lidhje me tarifën e transferimit dhe të marrë disa oferta potenciale para se të marrë vendimin përfundimtar. Disa ofrues shërbimesh ofrojnë tarifa më të ulëta për një grup shtetesh të caktuara - mundohuni të merrni gjithë informacionin e rëndësishëm për rastin tuaj.



VINI RE

Vetëm me **përdorimin e kanaleve të rregulluara** mund të jeni të sigurt që dërgesa juaj do të arrijë shpejt dhe sigurt tek pranuesi. Dërguesi disponon gjithmonë konfirmimin bankar, si dhe informohet për ecurinë e procesit, në rast se gabimisht paratë nuk kanë ardhur tek ju. Kështu kurseni kohën tuaj dhe jeni të sigurt për paratë tuaja.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore e
Republikës së Kosovës**

Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



THE WORLD BANK

IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telephone: +1 202 473-1000